



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës

Opština Priština – Municipality of Prishtina



ANEKS KONTRATA

Datë: 14.10.2019

Në mes të

KOMUNA E PRISHTINES, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë; dhe


Operatorëve Ekonomik: K.N.P.SH. "Papenburg & Adriani Company" sh.p.k. adresa: Ferizaj, me numër të regjistrimit të biznesit 810652942 dhe numër fiskal 810652942 i përfaqësuar nga Muhamet Dervishi - Drejtor, në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punët e shënuara me poshtë:

- i. Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: **"Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve"** me nr. të prokurimit **616 19 038 521 – Lot 2: "Ndërtimi i rrugës Besi - Marec"** të datës: 23.07.2019, e cila kontratë është në realizim e sipër.
- ii. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mos përfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për: **"Ndërtimi i rrugëve dhe kanalizimeve"** me nr. të prokurimit **616 19 175 525 – Lot 2: "Ndërtimi i rrugës Besi – Marec – punë shtesë"** Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës 02.08.2019 me kushte të njëjta si në kontratën bazë.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përmbyshur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: **19.460,73 € (Nëntëmbëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë euro dhe shtatëdhjetë e tre cent)** sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. **616 19 175 525**.
3. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
4. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
5. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
6. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	Zekë Bardhaj	Emri:	Muhamet Dervishi
Pozita:	Udhëheqës i Prokurimit	Pozita:	Drektor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	14.10.2019	Data:	14.10.2019
Vula:		Vula:	

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë shqipe.
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është <i>10% e vlerës së ofertës në vlerë prej: 1.946, 70 (njëmijë e nëntëqind e dyzet e gjashtë euro dhe shtatëdhjetë cent) në afat prej: 90 ditësh</i>
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës.
	12.2	Periodha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimit të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit të kontratës.

	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: 60 ditë
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim nga ZKA
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës së kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë të mbajtura me garancion bankar "me kërkesë". Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjatë tërë periudhës së defekteve: 5 vite
Shkaqet për kompensim	30.1	/
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 5 vite
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.

		ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë. Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.
--	--	---

1 of 4

Paramasa me Paralogari për rrugët anësore në kuadër të projektit “Ndërtimi i rrugës Busi-Marec”					
KOMUNA E PRISHTINËS					
Gjatësia, L=500.00 m'					
Nr. rendor	Lloji i punës	Njësia	Sasia	Çmimi njësi (Euro)	Çmimi total (Euro)
PUNËT PARAPRAKE					
1	Demontimi i rrethojave prej teli me gjemba.	m'	20.0	0.30	6.0
PUNËT PARAPRAKE				Gjithsej:	6.0
PUNIMET E DHEUT					
5	Gërmimi i dheut i kategorisë së III-të, IV-të dhe V-të me ngarkim dhe bartje deri në deponi në largësi 10km.	m³	494.0	2.00	988.0
9	Punimi i mbushjes dhe stabilizimi me material mbushës guror jokohorent (furnizimi dhe transporti), shtrirje në shtresa dhe ngjeshje me CBR>20%.	m³	100.0	4.00	400.0
10	Punimi i bankinës prej materialit guror.	m³	200.0	5.00	1,000.0
11	Hapja e kanaleve anash rruges.	m'	300.0	0.50	150.0
GJITHSEJ PUNIMET E DHEUT NË RRUGËN KRYESORE					2,538.0
MBISTRUKTURA					
12	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit (70MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-60mm me trashësi t=30cm	m³	371.2	6.00	2,227.2
13	Furnizimi, bartja, shtrirja dhe ngjeshja e tamponit (90MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31mm me trashësi t=10cm	m³	247.5	7.00	1,732.5
14	Furnizimi dhe punimi i asfaltit binder 0-22 mm me trashësi t=8.00cm duke inkorporuar edhe shtresën e parë të emulsionit.	m²	2,000.0	6.00	12,000.0
GJITHËSEJ PUNËT E MBISTRUKTURES					15,959.7
LËSHESAT RRETHORE					
17	Në thellësi 0-2 m në material të kater.III dhe IV	m³	25.0	1.00	25.0
18	Shtruerja e zhavorit si bazë e vendosjes së themeleve të Lëshesave	m³	8.0	5.00	40.0



19	Punimi i lëshesave monolite ose montazhe me koka hyrëse-dalëse, punimi komplet duke përfshirë edhe betonin MB30 për hyrje dhe dalje të lëshesave.				
	a) Ø 60cm	m'	24.0	33.00	792.0
	GJITHSEJ LËSHESAT RRETHORE				857.0
	TË NDRYSHME				
23	Analizat e materialve dhe ngjeshjes së trupit të rruges.	paushall	paushall	100.00	100.0
	GJITHSEJ PUNËT E NDRYSHME				100.0
REKAPITULIMI	Paramasa me Paralogari				
	Gjatësia, L=500.00 m'				
	PUNËT PARAPRAKE				6.00
	PUNIMET E DHEUT				2,538.00
	MBISTRUKTURA				15,959.70
	LËSHESAT RRETHORE				857.00
	TË NDRYSHME				100.00
	TOTALI				19,460.70 €





Kompania e Sigurimeve sh.a. - Insurance Company s.a.

KOSOVA e RE

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCIONIT
GUARANTEE INSURANCE POLICY

Nr. Serik 004406

Deklarat e Garancionit

Nr Policës
Policë Nr:

1008863

Sigurimi i Ekzekutimit

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES
(Autoriteti kontraktues)
Në emër të: K.N.P.SH."PAPENBURG & ADRIANI COMPANY"SH.P.K.
(Operatori ekonomik)
Titulli i aktivitetit: Ndertimi i rruges Busi-Marec (Aneks Kontrate)

Nr i Prokurimit: 616-19-175-525

Garancion me kërkesë te pare

DERISA operatori ekonomik i lartcekur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri e garancionit duke iu referuar dosjes, me numër të prokurimit/dosjes të lartcekur të dërguar nga Autoriteti Kontraktues;

DHE NGASE operatori ekonomik dëshiron të depozitojë sigurimin e garancionit në shumën e saktësuar të specifikuar në dosje;

DHE NGASE ne jemi pajtuar t'i japim operatorit ekonomik këtë sigurim:

ANDAJ NE të poshtë nënshkruarit, me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një total e shuma e sigurimit, zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mos përmbushja e njërit nga kushtet në vijim:

- 1 Autoriteti kontraktues ka konstatuar në bazë të dëshmive të vërtetueshme objektivisht se operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe kjo i ka shkaktuar autoritetit kontraktues dëme substancionale dhe/ose shpenzime të mëdha për mbylljen e kontratës në fjalë;
- 2 Operatori ekonomik ka dështuar që të ekzekutojë kontratën e nënshkruar dhe si rezultat i saj kanë mbet pa u paguar shumë punëtorë, nënkontraktorë dhe /ose furnizues të materialeve.

Pagesa në shumën e limituar deri ne shumën e sigurimit, siç është lartcekur, do të bëhet pa asnjë kundërshtim as ankesë, sa më shpejtë që është e mundur pas regjistrimit të kërkesës suaj me konfirmimin "e pranimit".

Shuma e Sigurimit €: 1,946.70

Ky sigurimi vlen deri: 12/01/2020

Nënshkrimi dhe marta e Garantuesit

Data e lëshimit: 14/10/2019





Kompania e Sigurimeve sh.a. - Insurance Company s.a.

KOSOVA e RE

POLICË PËR SIGURIMIN E GARANCIONIT
GUARANTEE INSURANCE POLICY

Nr. Serik 004406

Sigurimi i Ekzekutimit

Nr Policës
Poliv Nr:

1008863

Kontraktuesi:	K.N.P.SH."PAPENBURG & ADRIANI COMPANY"SH.P.K.				
Përfaqësuar nga:	MUHAMET DERVISHI				
Adresa:	Sojev-FERIZAJ				
Nr. i Biznesit:	810652942				
Garantuesi:	K.S. Kosova e Re SH.A				
Banka e Garantuesit:	BEK - Banka Ekonomike				
Përfituesi:	KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES				
Adresa e Përfituesit:	PRISHTINË				
Shuma e Sigurimit:	1,946.70				
Nmri i Prkurimit:	616-19-175-525				
Titulli i Kontratës:	Ndertimi i rruges Busi-Marec (Aneks Kontrate)				
Data e Fillimit:	14/10/2019	Data e Mbarimit:	12/01/2020		
Primi:	17.52	TVSH:	3.15	Totali:	20.67
Mënyra e pageses:	Transfer Bankar	Nr Llogaris:	1401000000597893		
Data e Lëshimit:	14/10/2019 00:00:00				

Lënda e garancisë

*Detyrimet e Siguruesit ndaj Përfituesit sipas kësaj
Police të sigurimit janë:*

- 1. Mbështetur në këtë Policë - Garancie, Siguruesi /
Garantuesi merr përsipër që të plotësojë çdo detyrim
kontraktor i cili është i garantuar me këtë policë.*
- 2. Përfituesi e ka të drejtën t'i drejtohet Siguruesit /
Garantuesit për marrjen e dëmshpërblimit deri në
shumën e garantuar, vetëm kur detyrimet
kontraktuale nuk plotësohen për faj të të Siguruarit /
Kontraktuesit - Ekzekutuesit të Kontratës.*
- 3. Me plotësimin e detyrimeve ndaj Përfituesit,
Siguruesit / Garantuesit i lind e drejta që t'i drejtohet
të Siguruarit / Kontraktuesit, me të gjitha mjetet
ligjore, për të bërë rimbursimin e shpenzimeve të
kryera në funksion të plotësimit të detyrimeve ndaj
përfituesit (cedimi i të drejtave nga Përfituesi të
Siguruesi / Garantuesi).*
- 4. Ky sigurim është lidhur sipas Kushteve të
Përgjithshme të Sigurimit të Garancive dhe
ekzekutimit të kontratës të cilat janë pjesë përbërëse
e kësaj Police.*
- 5. Për polica të sigurimit - Ekzekutimi i kontratave -
pjesë përbërëse e kësaj police është kontrata e
ekzekutimit të punëve ndërmjet autoritetit
kontraktues (Përfituesi) dhe Operatorit Ekzekutues
(të Siguruarit) si dhe marrëveshja e lidhur në mes
Siguruesit dhe Operatorit Ekonomik (hipoteka e lënë
peng).*

Me nënshkrimin e kësaj police të sigurimit pajtohem me K.S. Kosova e Re të l'ruaj të dhënat e mia personale/biznesit, të cilat do të përdoren nga kompania për qëllime statistikore, hulumtime dhe raportime në Regjistrin Kreditiv të Kosovës si dhe për trajtimin e dëmeve. Gjithsesi kuptohet se unë i siguruari me vullnet të lire, të barabartë dhe me informim kam pranuar primin e sigurimit dhe kam lexuar, kuptuar dhe pranuar kushtet e sigurimit të

Osman Rrudhani
Zyrtari i Shitjes



[Signature]
I Siguruari